



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË  
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1003/1 Prot.

Vlorë më, 11 .06. 2021

**VENDIM**

**Nr. 24, datë 11. 06. 2021**

**PËR  
MIRATIMIN E KRITEREVE PËR PROCEDURËN E PUNËSIMIT E PERSONELIT  
ADMINISTRATIV PËR POZICIONIN E PUNËS "MIRËMBAJTËS" PRANË  
SEKTORIT TË SHËRBIMEVE NË DSHM**

Në mbështetje të nenit 49 pika 1 gërma f, të ligjit nr. 80/ 2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*", nenit 40, pika 3 gërma e, nenit 52 të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë si dhe referuar shkresës nr. 952 prot, datë 03. 06. 2021 të Administratorit të UV-së, në mbledhjen e datës 11. 06. 2021 Bordi i Administrimit,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë propozimin e Administratorit, për kriteret për pozicionin e lirë të punës personeli administrativ "Mirëmbajtës", në Sektorin e Shërbimeve, Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse sipas shkresës nr. 952 prot, datë 03. 06. 2021 (kriteret bashkëlidhur).
2. Ngarkohet Drejtoria e Komunikimit dhe Burimeve Njerëzore për hapjen dhe ndjekjen e procedurës së punësimit për pozicionin e punës "Mirëmbajtës".
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**  
**Dr. ERVIS MOÇKA**





## PROPOZIM PËR KRITERET E PUNËSIMIT

### Për vend të lirë në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse pranë Sektorit të Shërbimeve

### MIRËMBAJTËS NË SEKTORIN E SHËRBIMEVE NË DREJTORINË E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE (NJË VEND I LIRË) SI MË POSHTË:

#### Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin si më sipër është:

Mirëmban ambjentet mësimore dhe jo mësimore, konstatimin dhe riparimin e dëmeve për mirëfunksionimin e punës në institucion.

#### **Kritere të përgjithshme që duhet të plotësoj/në kandidati/ët**

- Të jetë shtetas shqiptar/e
- Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të jetë i aftë nga ana shëndetsore për të kryer detyrën përkatëse;
- Të zotërojë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin e punës për të cilin konkuron;
- Të ketë aftësinë e punës në grup dhe të komunikimit etiko- profesional me kolegët dhe eprorët;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë të Gjykatës për kryerjen e një vepre penale si dhe të mos jetë person nën hetim;
- Kandidati nuk duhet të ketë patur background negativ në eksperiencat e mëparshme në punë dhe të mos jenë marrë ndaj tij masë disiplinore “largim nga puna”
- Të mos jetë në proces gjyqësor me Universitetin “Ismail Qemali” Vlorë;
- Të mos ketë vepruar ose propaganduar në drejtim të prishjes së imazhit të universitetit dhe autoriteteve drejtuese të UV-së, në median vizive dhe/apo të shkruar, rrjetet sociale etj.

#### **Kritere të veçanta që duhet të plotësoj/në kandidati/ët**

- Të ketë mbaruar minimalisht arsimin e mesëm.
- Eksperienca të mëparshme të punës në fushën e kërkuar përbën avantazh.
- Preferohet të jetë banor në qytetin e Vlorës.

#### **Dokumentacioni i kërkuar**

- Formulari i aplikimit i plotësuar nga aplikanti. Gjetet në adresën [www.univlora.edu.al](http://www.univlora.edu.al) ;
- Jetëshkrim/ CV;
- Diploma e shkollës së mesme (kopje e noterizuar);
- Libreza e punës (origjinale ose kopje të noterizuar);
- Raport mjekësor për aftësinë në punë, lëshuar 3 muajt e fundit (origjinal);



- Vërtetim i gjendjes gjyqësore (dokument origjinal i lëshuar nga Ministria e Drejtësisë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor dhe Prokuroria e Rrethit Gjyqësor);
- Fotokopje të kartës së identitetit ID;

Shënim:

*Diplomat, çertifikatat, gradat dhe titujt e fituar në institucione të huaja arsimore, të shoqërohen me çertifikatën e njehsimit, bazuar në nenin 92 të Ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e Arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë".*

### Mënyra e aplikimit

Dokumentat duhet të dorëzohen **vetëm nëpërmjet shërbimit postar** në adresën:

- **Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë,  
Lagjja. "Pavarësia", Rr. "Kosova" 9400 Vlorë,  
Shqipëri.**
- **Drejtoria e Komunikimit dhe Burimeve  
Njerëzore**
- **Për pozicionin: "Mirëmbajtës" pranë Sektorit  
të Shërbimeve në DSHM**

### Afati për aplikim

- ✓ Afati për të aplikuar është 2 dy (javë) kalendarike. Ky afat fillon nga data e nesërme e publikimit të njoftimit në [ëëë-site zyrtar të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë: ëëë.univlora.edu.al](http://ëëë.univlora.edu.al).

**KRYETAR**  
**Dr. Ervis MOCKA**

